

VENDIM
Nr. 997, datë 9.12.2020

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT “STANDARDET SHTETËRORE PËR
SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT GJEOPHAPËSINOR NË
SHQIPËRI – TEMA: BURIMET MINERALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, shkronja “z”, e 16, pika 1, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – tema: Burimet minerale”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin e përditësimin e të dhënave gjeohapësinore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

STANDARDET SHTETËRORE
**PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT GJEOPHAPËSINOR NË
SHQIPËRI – TEMA: BURIME MINERALE**

Përmbajtja

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

2. HYRJE

2.1 Qëllimi

2.2 Si lexohet dokumenti

2.3 Detyrimet ligjore

2.4 Fusha e veprimit

3. TEMA

3.1 Burimet minerale

3.1.1 Parathënie

3.1.2 Skemat e aplikimit dhe diagramet UML për temën “Burimet minerale”

3.1.3 Katalogu i tipologjisë

3.1.3.1 Aktiviteti në minierë

3.1.3.2 Burime tokësore minerale

3.1.3.3 Karakteristikat e minierave

3.1.3.4 Miniera

3.1.3.5 Produkti

3.1.3.6 Shfaqja e karakteristikave të minierave

3.1.3.7 Shfaqja e mineralit

3.1.3.8 Zbulimi i aktivitetit

3.1.3.9 Burimi

3.1.3.10 Matja e produktit

- 3.1.3.11 Matja e xeherorit
- 3.1.3.12 Pasuri natyrore
- 3.1.3.13 Rezerva
- 3.1.3.14 Emri i minierës
- 3.1.3.15 Modeli i depozitimit mineral
- 3.1.3.16 Përmasat e burimeve tokësore minerale
- 3.1.3.17 Vlerat e metodave të klasifikimit të përdorur
- 3.1.3.18 Vlerat e kodit të produktit
- 3.1.3.19 Vlerat e potencialit të përdorimit përfundimtar
- 3.1.3.20 Vlerat e tipit të zbulimit të aktivitetit
- 3.1.3.21 Vlerat e rezultatit të zbulimit
- 3.1.3.22 Vlerat e rëndësisë
- 3.1.3.23 Vlerat e gjendjes së minierës
- 3.1.3.24 Vlerat e grupimit të vendburimeve minerale
- 3.1.3.25 Vlerat e shfaqjes së mineralit
- 3.1.3.26 Vlerat e llojit të aktivitetit të minierave
- 3.1.3.27 Vlerat e llojit të aktivitetit të përpunimit
- 3.1.3.28 Vlerat e kategorisë së rezervës
- 3.1.3.29 Vlerat e kategorisë së burimeve
- 3.1.3.30 Vlerat e llojit të vendburimit mineral
- 3.2 Metadata
- 3.3 Kodi EPSG për KRGJSH-në
- 3.4 Cilësia e të dhënave
- 3.4.1 Përputhja logjike – Përputhja konceptuale (*Logical consistency – Conceptual consistency*)
- 3.4.2 Përputhja logjike – Përputhja me domënin (*Logical consistency – Domain consistency*)
- 3.4.3 Kërkesat minimale të cilësisë së të dhënave (*Minimum data quality requirements*)
- 4. ANEKSE
- 4.1 Aneksi A – Katalogu i tipologjisë
- 4.2 Aneksi B – Kodlistat
- 4.2.1 Vlerat e metodave të klasifikimit të përdorur
- 4.2.2 Vlerat e kodit të produktit
- 4.2.3 Vlerat e potencialit të përdorimit përfundimtar
- 4.2.4 Vlerat e tipit të zbulimit të aktivitetit
- 4.2.5 Vlerat e rezultatit të zbulimit
- 4.2.6 Vlerat e rëndësisë
- 4.2.7 Vlerat e gjendjes së minierave
- 4.2.8 Vlerat e grupimit të vendburimeve minerale
- 4.2.9 Vlerat e llojit të shfaqjes së mineralit
- 4.2.10 Vlerat e llojit të aktivitetit të minierave
- 4.2.11 Vlerat e llojit të aktivitetit të përpunimit
- 4.2.12 Vlerat e kategorisë së rezervës
- 4.2.13 Vlerat e kategorisë së burimeve
- 4.2.14 Vlerat e llojit të vendburimit mineral

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

Ky dokument përmban standardet e specifikimeve teknike të të dhënave gjeohapësinore për ndërtimin e NSDI-së, duke u mbështetur në direktivën Inspire. Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) në bashkëpunim me Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), të cilët janë autoritete publike përgjegjëse për temën “Burimet minerale”.

Data e publikimit të versionit nr. 1 është tetor 2018. Emërtimi i dokumentit është:

ASIG_Standard_NSDI_2018_BM_v.1, ku:

ASIG – autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit;

Standard – lloji i dokumentit;

NSDI – qëllimi i dokumentit;

2018 – viti i krijimit;

BM – tema për të cilën është krijuar standardi “Burimet minerale”, e cila i referohet temës “*Mineral Resources*” në direktivën Inspire;

v.1 – numri i versionit të standardit.

2. HYRJE

2.1 QËLLIMI

Ky dokument përcakton specifikimet teknike, të harmonizuara konform direktivës Inspire, për të dhënat gjeohapësinore të temës “Burimet minerale”, temë e cila është përcaktuar në nenin 11, pika 2/z, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Ky dokument publikohet si standard që përcakton rregullat bazë të implementimit të NSDI-së¹ në Shqipëri, me qëllim përdorimin e tij nga autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, që të arrihet një kuptueshmëri unike dhe korrekte e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore, për të realizuar ndërveprueshmërinë e tyre.

2.2 SI LEXOHEË DOKUMENTI

2.2.1 Struktura e dokumentit

Ky dokument është i organizuar në katër kapituj kryesorë:

1. Përshkrimi i standardeve – Në këtë pjesë jepet emërtimi dhe autori i standardeve.

2. Hyrje – Në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i gjithë informacioni dhe si mund të interpretohet më lehtë ai.

3. Tema – Në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për temën “Burimet minerale”.

4. Aneks – Në këtë pjesë jepen informacione shtesë, shpjeguese, në ndihmë të përdoruesve.

- Përmbajtja e Kapitullit të 3-të është strukturuar në 4 pjesë kryesore:

3.1 Përshkrimi i temës – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e temës, si dhe detajohen: diagramet UML dhe katalogu i tipologjive.

3.2 Metadata – Këtu jepen specifikimet teknike për metadatat e temës përkatëse.

3.3 Sistemi Koordinativ Referencë – Këtu përcaktohet Sistemi Koordinativ Referencë që është miratuar me vendimin nr. 669, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar me vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 322, datë 27.4.2016 dhe nr. 359, datë 29.5.2019.

3.4 Cilësia e të dhënave – Këtu jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementeve dhe matjes së tyre.

2.2.2 DIAGRAMET UML DHE KATALOGU I TIPOLOGJISË

Diagramet UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementet kryesore të specifikimeve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit gjeohapësinor, atributet dhe marrëdhëniet janë të përfshira në “Katalogu i tipologjive” (*Feature Catalogue*). Personat të cilët kanë ekspertizë tematike, por nuk janë të familjarizuar me UML-në, mund ta kuptojnë plotësisht përmbajtjen e modelit të të dhënave, duke u fokusuar te katalogu i tipologjive. Për përdoruesit e aplikacioneve, katalogu i tipologjive mund të jetë i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhëna të nevojshme për përdorim.

Në tabelat e mëposhtme shpjegohet përmbajtja dhe mënyra e organizimit të informacionit, në tabelat e të dhënave, në katalogun e tipologjive.

Tabelat nr. 1, 2, me anë të shembujve shpjegojnë mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e tipologjive dhe të attributeve të tyre.

Tabela nr. 3, me anë të një shembulli, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit në

¹ NSDI – Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor.

tabelën e kodlistës.

Tabela 1

Emri - Emërtimi i tipologjisë	
Përkufizimi	Përkufizimi sipas direktivës Inspire për tipologjinë.
Përshkrimi	Shënime dhe përshkrime të tjera për tipologjinë.
Lloji i tipologjisë	Tipi i elementit që mund të jetë i këtyre llojeve: “featureType” - një element që mund të jetë real, në terren, apo një dukuri abstrakte; “DataType” - një element tabelor, që shërben vetëm si tabelë attributesh, për t’u lidhur me një element tjetër; “enumeration” “codeList” - listë e parapërgatitur vlerash ku elementi duhet të marrë vlerë. <i>Enumeration</i> nënkupton “renditje vlerash”, ndërsa <i>codeList</i> nënkupton listë vlerash ose ndryshe “kodlistë”. Në dokument gjenden të shqipëruara si “numërtimet dhe kodlistat”; “union” - një mbulesë topologjike e dy ose më shumë grupeve të të dhënave gjeohapësinore, që ruan tiparet që bien brenda shtrirjes gjeohapësinore të të dyja grupeve të të dhënave hyrëse; “Imported” - të dhëna të specifikuar në tema të tjera të direktivës Inspire. Në dokument gjenden “Të dhënat e importuara”.
Gjeometria	Gjeometria e elementit sipas formatit vektor mund të gjendet në tri forma: pikë, linjë, poligon. Abstrakt – kur elementi nuk është element real në terren, por konsiderohet vetëm si dukuri.
Shumëllojshmëria	Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi: 0..* – mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnjë vlerë; 1..* – mund të marrë minimumi 1 vlerë ose shumë vlera; 0..1 – mund të mos marrë asnjë vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme; 1 – duhet të marrë detyrimisht 1 vlerë.
I detyrueshëm	Po – nëse atributi është i detyrueshëm të plotësohet; Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet.
Rol shoqërimi	Në tabelën e lidhjeve “Rol shoqërimet” tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementeve të ndryshme në këtë temë, si dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.

Tabela 2.

ATRIBUTET
-- Emri -- Emërtimi i atributit -- Përkufizimi -- Përkufizimi sipas direktivës Inspire të elementeve -- Përshkrimi -- Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin [I detyrueshëm: Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë, p.sh.: PO]

Tabela 3

ATRIBUTET
🔹 Vlera e parë e listës së gatshme, p.sh.: <i>Ligjor</i> -- Emri -- Emërtimi i vlerës -- Përkufizimi -- Përkufizimi sipas direktivës Inspire i elementeve.
🔹 Vlera e dytë (etj.) e listës së gatshme, p.sh.: <i>Joligjor</i> -- Emri -- Emërtimi i vlerës -- Përkufizimi -- Përkufizimi sipas direktivës Inspire i elementeve.

2.2.3 KARAKTERISTIKAT E “voidable” DHE SHUMËLLOJSHMËRIA

Stereotipi “voidable” përdoret për të përshkruar ato karakteristika të objekteve gjeohapësinore që mund të jenë ose mund të mos jenë të pranishme në grupet e të dhënave gjeohapësinore edhe pse mund të ekzistojnë në botën reale. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet t’u jepet një vlerë.

Për të gjitha karakteristikat e përcaktuara për objektet gjeohapësinore duhet të paraqitet një vlerë – ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave) ose vlera “void”. Një vlerë “void” nënkupton që nuk ekziston një vlerë përkatëse në grupet e të dhënave gjeohapësinore që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese.

Arsyeja e përdorimit të vlerës “void” duhet të paraqitet kurdo që të jetë e mundur, duke përdorur një nga vlerat e listuara në kodlistën *VleraEArsyeseSëPavlefshmërisë* (*VoidReasonValue*), e cila përmban:

- **E panjobur** (*Unknown*)

-- Përkufizimi --

Vlera korrekte për këtë element gjeohapësinor nuk njihet ose është e pamatshme nga krijuesi i të dhënave.

-- Përshkrim --

Shembull: Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit” e një ligeni të caktuar, nuk është matur, atëherë arsyeja e pavlefshmërisë së kësaj karakteristike mund të jetë “e panjobur”.

- **E papopulluar** (*Unpopulated*)

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë nuk është pjesë e databazës së mirëmbajtur nga krijuesi i të dhënave. Pavarësisht kësaj, kjo e dhënë mund të ekzistojë.

-- Përshkrim --

Shembull: Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit” nuk është e përfshirë në grupin e të dhënave që përmban objektin gjeohapësinor të ligenit, atëherë vlera e kësaj karakteristike mund të jetë “e papopulluar”.

- **Konfidenciale**

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë mund të ekzistojë, por është konfidenciale.

-- Përshkrim --

Shembull: Të dhënat personale të popullsisë të cilat ekzistojnë, por që nuk mund të shfaqen pasi mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Stereotipi “voidable” nuk jep asnjë informacion nëse ekziston një karakteristikë në botën reale. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristikë mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 0. P.sh., nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria e përkatësisë përkatëse do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 1. P.sh., nëse një njësi administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria e përkatësisë përkatëse do të jetë 1..*.

2.2.4 MBULIMET - COVERAGES

Funksionet e mbulimit *Coverages* përdoren për të përshkruar karakteristikat e një fenomeni të botës reale që zhvillohet në kohë dhe/ose hapësirë. Shembuj tipikë të tyre janë temperaturat, lartësitë, imazheritë etj. Një mbulim përmban një grup vlerash, të cilat shoqërohen me një element gjeohapësinor, kohor, kohor-gjeohapësinor. Domeinet tipike gjeohapësinore janë grupe pikash (p.sh., vendndodhja e sensorëve), kurbat përcaktuese (p.sh., izolinjat), rrjetet (p.sh., ortoimazheria, modelet e lartësive) etj.

Në skemat e aplikimit të Inspire, funksionet e mbulimit janë përcaktuar si vetitë e llojeve të objekteve gjeohapësinore ku lloji i vlerës së kësaj karakteristike është një realizim i një prej llojeve të specifikuar në SSH EN ISO 19123:2007.

Për të përmirësuar përputhjen me standardet e mbulimit në nivelin e zbatimit (p.sh., ISO 19136 dhe OGC Shërbimi i Mbulimit në Internet) dhe për të përmirësuar harmonizimin ndërtematik për përdorimin e mbulimeve në Inspire, një skemë e aplikimit për llojet e mbulimit është përfshirë në Modelin Konceptues të Përgjithshëm "*Generic Conceptual Model*".

Kjo skemë aplikimi përmban llojet e mëposhtme të mbulimit:

- *Rrjeti i Mbulimit i Korrigjuar (rektifikuar)*: Mbulimi, domeini i të cilit përbëhet nga një rrjet i korrigjuar, një rrjet për të cilin ka një transformim përfundimtar midis koordinatave të rrjetit dhe koordinatave të sistemit koordinativ referencë (shih figurën 1, djathtas, majtas).
- *Rrjeti i Mbulimit Referencë*: Mbulimi, domeini i të cilit përbëhet nga një rrjet referimi, një rrjet i lidhur me një transformim që mund të përdoret për të kthyer vlerat e koordinatave të rrjetit në vlerat e koordinatave të referuara në një sistem referimi koordinativ (shih figurën 1, djathtas).

Aty ku është e mundur përdoren vetëm këto lloje mbulimi (ose një nëntip i tyre) në skemat e aplikimit në Inspire.




Figura 1: Shembuj të një rrjeti të korrigjuar (majtas) dhe një rrjeti referues (djathtas)

2.2.5 NUMËRTIMET DHE KODLISTAT (ENUMERATION AND CODLIST)

Kodlistat modelohen si klasa në skemat e aplikimit, por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kodlistë, "vlera të tjera" përcaktojnë llojin e përmbajtjes së kodlistës, e përcaktuar specifikisht si më poshtë:

- "**jo**" përfaqëson kodlista që përmbajnë vetëm vlera të specifikuar në këtë dokument;
- "**të kufizuara**" përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuar në këtë dokument dhe vlera të tjera të limituara të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave;
- "**të hapura**" përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuar në këtë dokument dhe vlera shtesë në çdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave;
- "**po**" përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

Vlerat shtesë të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave nuk duhet të zëvendësojnë apo të modifikojnë vlerat ekzistuese të përcaktuara në dokument.

Në rastin kur ofruesit e të dhënave do të përdorin kodlista me vlera "**jo**", pra të specifikuar në

dokument, ofruesit janë të detyruar t'i bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistër. Kjo do të mundësojë që edhe përdoruesit e tjerë t'i kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t'i përdorin.

2.2.6 PARAQITJA E DIMENSIONIT KOHOR

Skemat e aplikimit përdorin atributin “FillimiICiklitJetësor” dhe “PërfundimiICiklitJetësor” për të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti gjeohapësinor.

Atributi “FillimiICiklitJetësor” specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinoe (në sistem). Atributi “PërfundimiICiklitJetësor” specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinoe (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në botën reale.

Ndryshimet që bëhen në atributin “PërfundimiICiklitJetësor” nuk shkaktojnë ndryshime në atributin “FillimiICiklitJetësor”.

◆ **Shënim i rëndësishëm**

Disa terma në katalogun e tipologjiave, si p.sh., FeatureType, DataType, Void, Coverages etj., nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën shqipe. Qëllimi parësor është që të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike, sipas termave të direktivës Inspire.

2.3 DETYRIMET LIGJORE

Në bazë të nenit 16, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, ASIG-u është përgjegjës për krijimin e standardeve për secilën nga temat e përcaktuara në ligj (neni 11), në përputhje me standardet evropiane (direktiva Inspire).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinoe, për krijimin e NSDI-së në Shqipëri, janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në direktivën Inspire, si dhe praktikave më të mira ndërkombëtare që mbështesin dhe bazohen në këtë direktivë. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të zbatojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave gjeohapësinoe.

Standardet (Rregullat e implementimit - IR) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- **Metadata** – Në këtë fushë direktiva përcakton standardet se si duhen të jenë metadatat. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjitha institucionet ose palët e treta (siç është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilët do të implementojnë atë (VKM nr. 1077, datë 23.12.2015).

- **Specifikimi i të dhënave** – Standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme që do të publikohen. Inspire ka përcaktuar disa attribute bazë të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë attribute të tjera për t'i bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të miratuara nga institucionet përgjegjëse lokale.

2.4 FUSHA E VEPRIMIT

Të gjitha autoritetet publike, kompanitë private apo individët që mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinoe për llogari të institucioneve publike, janë të detyruar t'i nënshtrohen këtij standardi.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva Inspire ka proceset dhe ciklin jetësor si më poshtë:




Figura 2: Proceset e ciklit jetësor

“Planifikimi” është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave.

“Vlerësimi” është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do të jetë certifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat që të përshkruhen me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

“Procesi (përpunimi)” është procesi gjatë të cilit mbledhen dhe modifikohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuara gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi janë bashkësi të dhënash gati për t’u publikuar.

“Shpërndarja” është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (qytetarët, autoritetet publike, organizatat ose palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, të përdorë, të analizojë ose të citojë të dhënat. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

“Zbulimi” është proces i vazhdueshëm gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jociësore në të dhënat e publikuara.

“Analiza” është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë këtij procesi merret vendimi çfarë do të bëhet me të dhënat që janë evidentuar.

“Përditësimi” është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara.

“Arkivimi” është procesi gjatë të cilit bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen arkivohen, duke u bazuar në standarde lokale dhe në legjislacionin në fuqi të vendeve ku implementohet. Rezultat i këtij procesi janë të dhënat që bëhen të paaksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen për arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose me standardet specifike.

“Shkatërrimi” është procesi gjatë të cilit të dhënat bëhen të parikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde lokale ose në legjislacione në fuqi.

3. TEMA

3.1 BURIMET MINERALE

3.1.1 PARATHËNIE

Tema *“Burimet minerale”* e përcaktuar si “Burimet minerale, ku përfshihen mineralet metalore, mineralet dhe shkëmbinjtë industriale, ku parësore është paraqitja e informacionit të rënies (thellësisë) mbi shtrirjen e burimeve”.

Tema *“Burimet minerale”*, e të dhënave gjeohapësinore, i referohet përshkrimit të

përqendrimeve natyrore, të burimeve minerale të ndryshme, me interes ekonomik potencial ose të dëshmuar. Atributet e rëndësishme, si: natyra, gjeneza, vendndodhja, shtrirja, minierat dhe shpërndarja e resurseve pasqyrojnë dy kategoritë kryesore të identifikuara të përdorimit të mundshëm. Këto janë:

- Menaxhimi i burimeve dhe aktiviteteve të shfrytëzimit dhe eksplorimit të tyre: sigurimi i informacionit mbi burimet minerale të përcaktuara, vlerësimi sasior i burimeve të pazbuluara të mineraleve, si dhe modelimi i vendburimeve.

- Vlerësimet e ndikimit në mjedis: hartimi dhe matja e parametrave gjeologjikë mjedisorë për vlerësimin e materialit gjeologjik që do të përdoret për ndërtimin dhe për përmirësimin e kushteve në vendin e minierës.

Modeli i të dhënave për temën “*Burimet minerale*” është i organizuar rreth dy kategorive kryesore të informacionit:

1. *Përshkrimin dhe vendndodhjen e minierave*
2. *Aktivitetet e minierës*

Përshkrimin dhe përcaktimin e vendburimeve, duke përfshirë klasifikimin e tyre, vlerësimet sasiore, si dhe një përshkrim të produkteve kryesore të tregut. Burimet energjetike, si: qymyr, nafta dhe gazi përjashtohen në këtë temë, pasi ato gjenden në temën “*Burimet e energjetike*”.

Mungesa e një linje të integruar të politikave të BE-së, për të siguruar pranimin e mjaftueshëm për lëndët e para me çmime të drejta dhe të pandryshuara, ka sjellë qasjen drejt një strategjie të re. Strategjia bazohet në 3 shtyllat e mëposhtme:

- të sigurojë *qasjen e lëndëve të para* nga tregjet ndërkombëtare nën të njëjtat kushte si konkurrentët e tjerë industrialë;

- të vendosë *kushtet e dubura* kornizë brenda BE-së, në mënyrë që të nxisë furnizimin e qëndrueshëm të lëndëve të para nga burimet evropiane;

- të *rrisë efikasitetin e përgjithshëm* të burimeve dhe të promovojë riciklimin për të reduktuar konsumin e BE-së të lëndëve primare dhe për të ulur varësinë relative të importit.

Çdo politikë e përdorimit të tokës për mineralet duhet të shfrytëzojë një bazë të fortë njohurish gjeologjike digjitale, që të sigurojë një vlerësim të drejtë dhe të barabartë për të gjitha përdorimet e mundshme të tokës, përfshirë këtu nxjerrjen përfundimtare të lëndëve të para.

Menaxhimi i mbetjeve nga industritë nxjerrëse (direktiva 2006/21/EC)

Një nga vetitë që përshkruan natyrën e mbetjeve duhet të përmbajë disa elemente, si: përshtatshmërinë dhe përputhjen me kategorinë e objektit të mbetjeve; përshkrimin e karakteristikave fizike dhe kimike të mbetjeve që duhet të depozitohen në afat të shkurtër dhe afatgjatë, me një referencë të veçantë; stabilitetin e saj në kushtet atmosferike/meteorologjike sipërfaqësore, duke marrë parasysh llojin e mineralit/mineraleve që duhet nxjerrë, si dhe natyrën e çdo ngarkese dhe mineralet gangue² (minerale pa interes ekonomik) që do të zhvendosen gjatë operacioneve nxjerrëse.

Modeli konceptual i të dhënave gjeohapësinore

Informacionet, si: vendndodhja e minierës; vendndodhja e mineraleve dhe disa attribute kryesore si lloji i shkëmbinjve ose mineraleve të nxjerra (p.sh., silikat - sulfide - radioaktive) të temës “*Burimet minerale*” mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në mjedis. Ky ndikim varet nga disa faktorë ose parametra të tjerë, si për shembull:

- *Lloji i shfrytëzimit*, ndikimi mjedisor i një karriere, kushtet e sipërfaqes së përdorur/problemet e përdorimit të tokës/ndotja vizuale nuk është e njëjtë me atë për një shfrytëzim nëntokësor (i cili, gjithashtu, ndonjëherë mund të ruajë mbetjet në varësi të metodës së shfrytëzimit).

- *Gjeometria e vendburimit* (shkalla, forma, rënia, gjerësia) dhe, gjithashtu, klasat e rezervave dhe burimeve, të cilat do të ndikojnë fort në llojin e shfrytëzimit.

- *Lloji i mineralit/mineraleve*, i cili do të përcaktojë llojin e përpunimit të mineralit/mineraleve dhe për këtë, llojin dhe sasinë e mbetjeve.

Modeli bazë i të dhënave për temën “*Burimet minerale*”, i zhvilluar nga komuniteti i gjeoshkencave ndërkombëtare paraqet elementet kryesore të objektit/vendit dhe shembujt e

përdorimit si: vendndodhja e burimeve minerale (*miniera* dhe *burimet tokësore minerale*), produktet kryesore dhe lloji i shfrytëzimit.

Materiali i papërpunuar – mineral është një substancë natyrale inorganike ose organike, si xeherorët metalorë, minerale industriale, materiale ndërtimi ose lëndë djegëse energjetike, por duke përjashtuar ujin.

Xeheror, çdo material natyror (i papërpunuar) nga i cili një mineral ose agregat mund të shërbejë si burim fitimprurës.

Megjithëse janë të njohura më shumë se 4,400 lloje minerale, vetëm rreth 100 konsiderohen “minerale xeherore”. Termi “xeheror” aplikohet fillimisht vetëm për mineralet metalorë, por tani përfshin substanca të tilla jometalore, si: squfuri, fluori i kalciumit (fluorit) dhe sulfati i baritit (barit). “Xeherorët” janë gjithmonë të përzier me shkëmbinj dhe minerale të padëshiruar, të njohur kolektivisht si gangue (minerale që s’kanë interes ekonomik). Xeherorët dhe gangue nxirren së bashku dhe pastaj ndahen. Elementi i dëshiruar (shpesh një metal i cili zakonisht gjendet në kombinimin kimik me disa elemente të tjera, përveç papastërtive të ndryshme) nxirret nga xeherori. Ai mund të jetë i rafinuar (i pastruar) ose i lidhur me metale të tjera. Një mineral metalor (xeheror) është pra një lloj shkëmbi (lëndë e parë minerale) nga i cili mund të përftohet metali.

Metalet mund të jenë të pranishme në xeherorë në formë të përbërë (si bakri fillestar) ose si metale të lindur (zakonisht nuk formojnë komponime, si ari), por në shumicën e rasteve ato paraqiten si okside, sulfide, sulfate, silikate etj. Por, gjithashtu, përfshihen substanca gjysëmmetalike ose metaloide të tilla si “As” dhe “Ge”, të cilat shpesh lidhen ngushtë me metalet.

Mineralet dhe shkëmbinj të industriale janë minerale të cilat nuk janë as metalorë, as përdoren si lëndë djegëse, por që nxirren dhe përpunohen për përdorimin e tyre ekonomik. Një përkufizim më i gjerë përshkruan një mineral industrial si çdo lëndë shkëmbore, minerale ose substanca natyrore që ka vlera ekonomike, pa mineralet metalorë, lëndët djegëse minerale dhe gurët e çmuar. Në thelb, ato janë lëndët e para të përdorura në shumë produkte industriale, bujqësore dhe ndërtimore. Megjithatë, për lehtësi, gurët e çmuar shpesh grupohen së bashku me mineralet industriale në një grup.

Rënia (thellësia) është një informacion që lidhet me informacione të tjera, për të paraqitur të dhëna të plota, që tregojnë llojin dhe morfologjinë e vendburimit (p.sh., damari, vendburime masive, shtresa etj.) dhe gjeometrinë e tij, veçanërisht zhytjen. Rënia (thellësia) e vendburimit, e kombinuar me informacionin që lidhet me morfologjinë dhe gjeometrinë, do të përcaktojë metodën e punës (p.sh., hapësira e hapur ndaj minierave nëntokësore) dhe trashësinë e mbingarkesës së panevojshme (në rast të minierave të hapura).

Llojet kryesore të objekteve gjeohapësinore, të të dhënave e specifikimeve të temës “Burimet minerale”.

Llojet kryesore të objekteve gjeohapësinore për *Burimet Minerale* janë, *Shfaqja minerale*, *Produkti*, *Minierat* dhe *Zbulimi i Aktivitetit*, si dhe *Aktiviteti në Minierë*.

Klasa e *Karakteristikave të minierave* përfaqëson një tipar konceptual që është i njohur dhe korrespondon me një “Minierë” ose një “Aktiviteti në Minierë”. Kjo klasë zotëron karakteristika të gjetshme dhe të identifikueshme në kohë dhe hapësirë. *Shfaqja e Karakteristikave të Minierave* është një dukuri e një funksioni mineral - miniera, mbart gjeometrinë dhe vendndodhjen.

- Minierë është çdo gërmim që shërben për nxjerrjen e mineraleve nga vendburimet (*depozitat*). Minierat e zakonshme hapen me punime nëntokësore dhe karriera (të quajtura edhe miniera në qiell të hapur) në përgjithësi për nxjerrjen e mineraleve metalore. Lloji sipërfaqësor i *Minierave*, përfshin, gjithashtu, punime të hapura për nxjerrjen e mineraleve industriale, zakonisht të referuara si gurore.

- Veprimtaria minerale, e lidhur me një minierë, përshkruan procesin e nxjerrjes së mineraleve metalore ose jometalore nga toka.

Burimet Tokësore Minerale identifikojnë llojet e fenomeneve të vëzhgueshme ose të konstatuara për klasifikimin e vendburimeve ekonomike dhe joekonomike:

- Zona me rrezik mineral mund të jetë një perspektivë, një ngjarje minerale, një vendburim xeheror (metalor) etj. (por jo një fushë, një distrikt ose një krahinë).
- Produktet përshkruajnë materialin në bazë të interesit ekonomik për *Burimet Tokësore Minerale*.
- *Matja e Xeherorit* është një sasi e vlerësuar ose e llogaritur e xeherorit dhe klasës që ekziston brenda një vendburimi, në kuptim të burimit, rezervës dhe pasurimit natyror.
- *Modeli i Depozitimit Mineral* përshkruan atributet thelbësore të një klase të vendburimeve minerale të përdorura për të klasifikuar *Burimet Tokësore Minerale*.
- Një *Burim Tokësor Mineral* ka një *Zbulimi i Aktivitetit* të lidhur për të përshkruar procesin që çon në zbulimin dhe vlerësimin e vendburimit.

Modeli i të dhënave për temën “*Burimet minerale*” përdor *klasat* nga modeli i të dhënave të temës “*Gjeologjia*”. Vendburimet kanë tipare gjeologjike, të cilat kanë një gjeometri (*Mapped Feature*) dhe një event gjeologjik. Historia e hulumtimit është e nevojshme për vlerësimin sasiar të *burimeve minerale* ekzistuese dhe të pazbuluara të një zone. Një informacion i tillë mund të ndihmojë, gjithashtu, në vlerësimin e potencialit të një shfaqjeje (p.sh., sondazhin e marrjes së mostrave, studimin e shpimit).

Nocioni i rajonit metalogjenik është veçanërisht i dobishëm dhe është i pranishëm në disa baza të dhënash. Kjo lejon që një vendburim të vendoset në një kornizë më të përgjithshme dhe të trajtojë konceptin e potencialit mineral në një shkallë rajonale. Në modelin e *burimeve minerale* kjo mund të përshkruhet duke përdorur elementin e tipit *Shfaqja Minerale*.

Anomalitë e resurseve minerale:

“Anomalitë”, vende ku përqendrimet e elementeve potencialisht të vlefshëm në tokë, sedimentet e lumenjve ose gurët në tokë ose në det të hapur, tejkalojnë vlerat normale të sfondit të pritshëm, duke pasur parasysh kontekstin gjeologjik lokal. Harta të tilla përdoren gjerësisht në eksplorimin e mineraleve. Atributet janë vendndodhja, elementet kimike, natyra e elementit/elementeve të mostrës, vlerës analitike.

Anomalitë nuk janë vetëm të natyrës gjeokimike, por, gjithashtu, mund të jenë gjeofizike. Një anomali nuk ka vlerë të brendshme deri sa të jetë karakterizuar me saktësi nga një studim i hollësishëm gjeologjik, një studim më të hollësishëm gjeofizik/gjeokimik. Pra nëse konfirmohet që ka interes, kryhet një sondazh zbulimi.

Shumica e anomalive nuk kapen kurrë në zbulimin e një vendburimi, kjo vjen si pasojë e lidhjes me heterogjenitetin litologjik të kores. Në disa raste, ato mund të tregojnë se një proces mineralizimi filloi por u ndërpre shpejt, duke mos arritur në përqendrim mineral. Nga ana tjetër, shumë vendburime nuk janë (asnjëherë) të karakterizuara nga anomalitë gjeofizike/gjeokimike për disa arsye: rënia (thellësia), mbulesa, mungesa e kontrastit midis shkëmbit pritës dhe trupit të xeherorit etj.

Edhe nëse sondazhet gjeokimike/gjeofizike janë të dobishme për hartimin e “parashikueshmërisë”, në shumicën e kohës, janë të disponueshme vetëm sondazhet në shkallë të gjerë të publikuara nga organet publike. Interesi i tyre në përgjithësi është shumë i kufizuar. Sondazhet e detajuara të bëra nga kompanitë private, janë rrallë të arritshme, për shkak të rëndësisë së tyre strategjike.

3.1.2 SKEMAT E APLIKIMIT DHE DIAGRAMET UML PËR TEMËN “BURIMET MINERALE”

Një përmbledhje e skemës së aplikimit të *Burimeve Minerale* është dhënë në figurën 3, e cila tregon vetëm llojet e objekteve gjeohapësinore, llojet e të dhënave dhe marrëdhëniet e tyre. Vetitë e tyre nuk janë të dukshme në këtë fazë, por sqarohen në figurat e mëposhtme. Siç mund të shihet, modeli i të dhënave ka dy komponentë kryesorë: i pari është i përqendruar te *Vendburimet*, përshkruan materialin natyror të vlerës së mundshme ekonomike (figura 4 dhe figura 5), dhe i dyti është i përqendruar në *Karakteristikat e Minierave* (figura 6), ku përshkruan si funksionojnë *Vendburimet*.




Figura 3: Diagrami i klasës UML: Përmbledhje e skemës së aplikimit të burimeve tokësore minerale

Burimet Tokësore Minerale identifikojnë llojet e fenomeneve të dukshme ose të konstatuara, që janë të nevojshme për t'u klasifikuar vendburimet ekonomike dhe joekonomike:

- *ShfaqjaEMineralit* mund të perceptohet si një pikë, një dukuri, një vendburim minerale, një vendburim xeheror (por jo një fushë, një distrikt apo një provincë).
- *Produkti* përshkruan materialin me interes ekonomik për *BurimetTokësoreMinerale*.
- *MatjeEProduktit* siguron një matje të sasisë së produktit (në krahasim me sasinë e xeherorëve), bazuar në llogaritjen e sasisë së rezervave të vendburimit, burimeve ose përftimeve të llogaritura.
- *MatjaEXeherorëve* përbën një ose disa sasi të llogaritura të xeherorëve dhe nivelin që ekziston brenda një *BurimiTokësorMineral*, në kuptimin e resurseve, rezervave dhe përmbajtjes së xeherorëve.
- Modeli i vendburimit mineral përshkruan atributet kyçe të klasës së vendburimeve minerale, të përdorura për të klasifikuar *BurimetTokësoreMinerale*.
- Një *BurimiTokësorMineral* ka një lidhje me *ZbulimiAktivitetit*, që përshkruan procesin që të drejton në zbulimin dhe vlerësimin e burimit.
- Klasa abstrakte e *KarateristikaveTëMinierave* paraqet një tipar koncept që është i njohur. Kjo lidhet me *Minierat* ose dhe me *AktivitetinNëMinierë*, me karakteristika të gjeshme dhe të identifikueshme në kohë dhe/ose në hapësirë.

Burimet tokësore

Diagrami për *Burimet Tokësore Minerale* ndahet në dy pjesë për lehtësi në kuptimin e saj (fig. 4 dhe fig. 5).




Figura 4. Diagrami i klasës UML: Burimet tokësore minerale - pjesa I




Figura 5: Diagrami i klasës UML: Burimet tokësore minerale - pjesa II

Një *ShfaqjaEMineralit* është një lloji i *BurimeveTokësoreMinerale* dhe *HistorikuIKërkimit* lidhur nga *BurimeveTokësoreMinerale* me *ZbulimiLAktivitetit* përshkruan se çfarë lloj punimesh janë kryer për të gjetur dhe vlerësuar *ShfaqjenMinerale*.

Modeli i të dhënave të *Burimeve minerale* përdor Modelin e të dhënave Gjeologjike të Inspire, për të përshkruar komponentët gjeologjikë. Klasa e *BurimeveTokësore* trashëgon nga super klasë të *KarakteristikaveGjeologjike* nga standardi i temës “Gjeologjia”. Gjeometria sigurohet nga paraqitja e lidhjes ndërmjet *KarakteristikaveGjeologjike* dhe *TipologjiveLidhur*² të paraqitura në specifikimin e të dhënave të gjeologjisë.

Përshkrimi i produktit lidhet nga *BurimeveTokësoreMinerale* me *Produktet* dhe përshkruan materialin me interes ekonomik të *BurimeveTokësoreMinerale*.

SasiaEXeherorëve lidhet nga *BurimeveTokësoreMinerale* me *MatjenEXeherorëve* dhe sigurojnë vlerësimin e sasisë dhe dimensionet e vendburimeve.

MatjaEXeherorëve mund të jetë një burim, rezervë ose pasuri natyrore. Kategoria e *Burimeve* tregon nëse burimi është i matur, shënuar, i testuar, i mundshëm ose i nxjerrë dhe për rezervën, identifikon nivelin e besueshmërisë së vlerësimit. Treguesi (përfshirë rezervat dhe burimet) paraqet se çfarë përfshihet apo jo në vlerësim.

² MappedFeature.

Matja e detajeve vjen nga lidhja *MatjaEXeherorëve* me *MatjenEProduktit*, që sigurojnë një matje të sasisë së produktit (në krahasim me sasinë xeheror), bazuar në llogaritjen e rezervës, burimit ose të përfimit. Kjo matje përftohet nga shumëzimi i *sasisë së xeherorëve* me vlerën mesatare të produktit së bashku me xeherorët (zakonisht shprehur në njësi matëse ton).

Interesi i produktit vjen si pasojë e lidhjes së *MatjaEProduktit* me *Produktin* dhe tregon se cili produkt mund të jetë me interes brenda një vendburimi. Një vendburim mund të jetë shumë i madh për një produkt (ky produkt është kryesor).




Figura 6: Burimet minerale - Miniera

3.1.3 KATALOGU I TIPOLOGJISË

3.1.3.1 AKTIVITETI NË MINIERË

--Emri--

Aktiviteti në minierë

-- Përkufizimi --

Procesi i nxjerrjes së mineraleve metalorë, mineraleve jometalore ose shkëmbinjeve industrialë nga Toka.

-- Përshkrimi --

Termi mund të përfshijë edhe trajtimin paraprak, p.sh., pastrimin ose matjen.

-- Tipi i elementit--

Feature Type

LIDHJE STRUKTURE TË JASHTME

 Gjeneruar nga “featureType” AktivitetiNëMinierë te “featureType” KarakteristikatEMinierave

ATTRIBUTE

 KohëzgjatjaEAktiviteit: TM_Periodhë

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Kohëzgjatja e aktivitetit

-- Përkufizimi --

Periodha ose zgjatja në kohë e AktivitetitNëMinierë.

-- Përshkrimi --

Fillimi i aktivitetit lidh TM_Periodhë me TM_Moment në të cilën fillon. Fundi lidh TM_Periodhë me TM_Moment në të cilën përfundon. Për një sërë arsyes, pozicioni i TM_Moment i caktuar nga fillimi ose fundi mund të jetë i papërcaktuar.

[I detyrueshëm: PO]

 LlojiIAktivitetit: VleratELlojitTëAktivitetitNëMinierë

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Lloji i aktivitetit

-- Përkufizimi --

Tipi i ZbulimiIAktivitetit.

-- Përshkrimi --

Shembull: Hartografimet gjeologjike, shpimet, shërbimet gjeofizike, hartografimet gjeokimike etj.

[I detyrueshëm: PO]

 LlojiIPërpunimit: VleratELlojitTëAktivitetitTëPërpunimit

Shumëllojshmëria:[1]

-- Emri --

Lloji i përpunimit

-- Përkufizimi --

Lloji i përpunimit të kryer gjatë AktivitetitNëMinierë.

[I detyrueshëm: PO]

 XeheroniPërpunuar: Sasia

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Xeheroni i përpunuar

-- Përkufizimi --

Sasia e mineralit xehesor të përpunuar nga aktiviteti.

[I detyrueshëm: PO]

LIDHJE

 Lidhje (Drejtimi: Burimi -> Objektivi)

Burimi: (Class) AktivitetiNëMinierë “featureType”

Objektivi: Vendburim (Class) Vendburim “featureType”

Shumëllojshmëria: [1]

--Përkufizimi--

Vendburimi me të cilin një aktivitet në Minierë është lidhur.

 Lidhje (Drejtimi: Burimi -> Objektivi)

Burimi: (Class) AktivitetiNëMinierë”featureType”

Objektivi: “voidable” LëndaeParë (Class) Material i Nxjerrë “DataType”

Shumëllojshmëria: [1..*]

--Përkufizimi --

Xeheroni, shumë rrallë është nxjerrë i vetëm. Në shumicën e rasteve është i shoqëruar nga një sasi e ndryshueshme gangue, me mineralizim të ulët ose krejtësisht i pangopur i përbërë nga Minerale jometalore (ndonjëherë me interes).

LIDHJE	
 Lidhje (Drejtimi: Burimi -> Objektivi) Burimi: (Class) <i>AktivitetiNëMinierë</i> “featureType”	Objektivi: “voidable” Prodhimi i Mbetjeve (Class) MbetjetMinerale”FeatureType” Shumëllojshmëria: [1..*] --Përkufizimi -- Mbetjet e produkteve nga një aktivitet në minierë, që janë krijuar gjatë fazës së përpunimit.
 Lidhje (Drejtimi: Burimi -> Objektivi) Burimi: (Class) <i>AktivitetiNëMinierë</i> “featureType”	Objektivat: “voidable” MinieraeLidhur (Class) <i>Minera</i> “featureType” Shumëllojshmëria: [1] --Përkufizimi -- Miniera ku po zhvillohet <i>AktivitetiNëMinierë</i>.
 Lidhje (Drejtimi: Burimi-> Objektivi) -- Përkufizimi-- Miniera ku po zhvillohet ose është zhvilluar <i>AktivitetiNëMinierë</i>. Burimi: (Class) <i>AktivitetiNëMinierë</i> “featureType”	Objektivi: “voidable” MinieraeLidhur (Class) <i>Minera</i> “featureType” Shumëllojshmëria: [1] -- Përkufizimi -- Miniera ku po zhvillohet ose është zhvilluar <i>AktivitetiNëMinierë</i>.
 Lidhje (Drejtimi: Burimi ->Objektivi) -- Përkufizimi-- Vendburimi me të cilën, aktiviteti në minierë është i lidhur. Burimi: (Class) <i>AktivitetiNëMinierë</i> “featureType”	Objektivi: “voidable” Vendburim (Class) <i>Burime Tokësore Minerale</i> “featureType” Shumëllojshmëria: [1] -- Përkufizimi -- Vendburimi me të cilën, <i>AktivitetiNëMinierë</i> është i lidhur.
 Lidhje (Drejtimi: Burimi -> Objektivi) Burimi: Public (Class) <i>AktivitetiNëMinierë</i> “featureType”	Objektivi: Public MaterialiiProdhuar (Class) <i>Produkti</i> “featureType” Shumëllojshmëria: [1..*] -- Përkufizimi -- Produkt(et) e përpunuara nga <i>AktivitetiNëMinierë</i>, përmes një faze përpunimi. Zakonisht në formën e koncentrateve që përmbajnë një apo disa produkte në klasat e ndryshme për xeherorë metalorë.
 Lidhje(Drejtimi: Burimi -> Objektivi) Burimi: (Class) <i>Minera</i> “featureType”	Objektivi: AktivitetiLidhur (Class) <i>AktivitetiNëMinierë</i> “featureType” Shumëllojshmëria: [1..*] -- Përkufizimi -- <i>AktivitetiNëMinierë</i> në lidhje me Minierën.

LIDHJE	
 Lidhje (Drejtimi: Burimi-> Objektivi)	
-- Përkufizimi -- <i>AktivitetiNëMinierë</i> në lidhje me Minierën.	
Burimi: (Class) <i>Minera</i> "featureType"	Objektivi: AktivitetiLidhur (Class) <i>AktivitetiNëMinierë</i> "featureType" Shumëllojshmëria: [1..*] -- Përkufizimi -- <i>AktivitetiNëMinierë</i> në lidhje me <i>Minierën</i> .
 Lidhje (Drejtimi: Burimi -> Objektivi)	
Burimi: (Class) <i>BurimeTokësoreMinerale</i> "featureType"	Objektivi: "voidable" Nxjerrja e Burimeve (Class) <i>AktivitetiNëMinierë</i> "featureType" Shumëllojshmëria: [1..*] -- Përkufizimi -- Tregon nëse ky burim është subjekt i shfrytëzimit, dhe nëse po cilit lloj i përket. Në varësi të disa faktorëve (lloji i mineralizimit, madhësisë, nivelit, formës, thellësisë etj.) Mund të përdoren një ose disa metoda (të kombinuara), duke përfshirë metodat jashtë zonës, minierat sipërfaqësore (ndër të cilat metodat që lidhen me shfrytëzimin e vendburimeve aluviale/eluviale) dhe minierat nëntokësore. Njohuria për këto metoda është e rëndësishme pasi mund të jetë e lidhur ngushtë, me sasinë dhe llojin e mbetjeve gjithashtu dhe me ndikimet mjedisore të krijuara nga nxjerrja.
 Lidhje (Drejtimi: Burimi -> Objektivi)	
-- Përkufizimi -- Një ose më shumë periudha të <i>AktivitetitNëMinierë</i> , të <i>BurimeveTokësoreMinerale</i> .	
-- Përshkrimi -- Tregon nëse ky burim është subjekt i shfrytëzimit, dhe nëse po, i cilit lloj. Në varësi të disa faktorëve (lloji i mineralizimit, madhësisë, nivelit, formës, thellësisë etj.) Mund të përdoren një ose disa metoda (të kombinuara), duke përfshirë metodat jashtë zonës, minierat sipërfaqësore (ndër të cilat metodat që lidhen me shfrytëzimin e vendburimeve aluviale/eluviale) dhe minierat nëntokësore. Njohuria për këto metoda është e rëndësishme pasi mund të jetë e lidhur ngushtë, me sasinë dhe llojin e mbetjeve gjithashtu dhe me ndikimet mjedisore të krijuara nga nxjerrja.	
Burimi: (Class) <i>BurimeTokësoreMinerale</i> "featureType"	Objektivi: "voidable" Nxjerrja e Burimeve (Class) <i>AktivitetiNëMinierë</i> "featureType" Shumëllojshmëria: [0..*] -- Përkufizimi -- Një ose më shumë periudha të aktivitetit në minierë, të <i>burimeve tokësore minerale</i> . -- Përshkrimi -- Tregon nëse ky burim është subjekt i shfrytëzimit, dhe nëse po, i cilit lloj. Në varësi të disa faktorëve (lloji i mineralizimit, madhësisë, nivelit, formës, thellësisë etj.) Mund të përdoren një ose disa metoda (të kombinuara), duke përfshirë metodat jashtë zonës, minierat sipërfaqësore (ndër të cilat metodat që lidhen me shfrytëzimin e vendburimeve aluviale/eluviale) dhe minierat nëntokësore. Njohuria për këto metoda është e rëndësishme, pasi mund të jetë e lidhur ngushtë, me sasinë dhe llojin e mbeturinave gjithashtu, dhe me

LIDHJE	ndikimet mjedisore të krijuara nga nxjerja.
--------	---

3.1.3.2 BURIME TOKËSORE MINERALE

--**Emri**--

Burime tokësore minerale

-- **Përkufizimi**--

Llojet e vrojtimeve ose fenomeneve të konstatuara ose të matura që kërkohen për të klasifikuar burimet tokësore minerale ekonomike dhe joekonomike.

-- **Tipi i elementit**--

Feature Type

LIDHJE STRUKTURE TË JASHTME
➦ Agreguar nga <i>"featureType" BurimeTokësoreMinerale</i> te <i>"featureType" BurimeTokësore Minerale</i>
